

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Universiteti	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
Njësia akademike	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës
Programi	Inxhinieri Industriale me Informatikë
Titulli i lëndës	Ndërmarrësi dhe Inovacion
Niveli	Bachelor
Statusi lëndës	Obligative
Viti i studimeve	I, Semestri II
Numri i orëve në javë	3
Vlera në kredi – ECTS	4
Koha / lokacioni	
Mësimdhënësi i lëndës	
Detajet kontaktuese	
Përshkrimi i lëndës	<i>Ndërmarrësia dhe Inovacioni i pajisë studentët me njohuri mbi ndërmarrësit, karakteristikat e tij si dhe rëndësinë dhe natyrën e inovacioneve. Lënda do të trajtojë: Përkufizimin e ndërmarrësisë dhe inovacionit, natyra e Inovacioneve dhe të menduarit kreativ, organizimi i inovacioneve dhe ndërmarrësia, angazhimet dhe procesi i krijimit të një ndërmarrëjeje, cikli jetësor i produktit dhe rëndësia e krijimit të produkteve të reja dhe inovative, analiza e biznesit ekzistues, prezantimi i biznesit, analiza e pozitës konkurruese, objektivat, analiza e tregut , hulumtimi i tregut, përkufizimi i konsumatoreve, segmentimi i tregut, analiza e konkurrencës, plani i marketingut, krijimi dhe organizimi i NVM-ve, planifikimi i biznesit etj</i>
Qëllimet e lëndës	<i>Qëllimi i lëndës është që studentët të njohin konceptet themelore mbi ndërmarrësin dhe inovacionin. Të familiarizojë studentët me procesin e krijimit të ideve të reja (produkteve, shërbimeve apo edhe mënyrave të reja të zigjdhjes së problemeve), mënyrat e testimit të idesë ndërmarrëse dhe inovative, krijimi dhe përpilimi i planit të biznesit si dhe menaxhimin e ndërmarrjes.</i>
Rezultatet e pritura të mësimnxënies	<i>Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të:</i> <i>• kuptojnë konceptin e ndërmarrësisë dhe inovacionit;</i> <i>• njohin procesin e krijimit të ideve të reja,</i> <i>• krijojnë dhe hartojnë një plan biznesi;</i> <i>• njohin menaxhimin dhe strukturën organizative të ndërmarrësisë.</i>
Parakushtet	N/A
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)	

Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti
Mësim teorik dhe praktik	3	15	45
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	4	4
Ushtrime në terren			
Kollokviume, seminare deh projektet	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	6	12
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz dhe provim final)	1		1
Projektet dhe prezantimet	1	4	4
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies	Ligjerata dhe ushtrime të kombinuara me raste te studimit, punime seminarike, plane biznesi dhe diskutime në klasë;		
Metodat e vlerësimit	Studenti mund të zgjedhë për t’u vlerësuar njërën nga dy format e vlerësimit, dhënë më poshtë: 1. Forma 1: Vlerësimi me kollokviume dhe projekt 2. Forma 2: Vlerësimi me provimin përfundimtar. Forma 1: Në formën e parë të vlerësimit” Vlerësimi me kollokviume dhe projekt “studenti vlerësohet në katër aktivitete që realizohen gjatë ligjëratave: 1. Kollokvium 1 (35%), vlerësim individual 2. Kollokvium 2 (35%), vlerësim individual 3. Aktiviteti në klasë (10%), vlerësim individual 4. Projekti (20%), vlerësim grupor. Sqarim shtese: Nëse studenti në secilin aktivitet të mësipërm arrin pikët maksimale, atëherë ai do të vlerësohet me 100 pikë. Studentët të cilët e kalojnë provimin sipas formës 1 të vlerësimit, lirohen nga obligimi për t’iu nënshtruar provimit final. Vetëm nëse studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin e arritur sipas formës 1, atëherë ai mund t’i nënshtrohet provimit final për të përfituar vlerësim më të lartë. Forma 2: Në formën e dytë të vlerësimit” Vlerësimi me provimin përfundimtar”, studenti do t’i nënshtrohet provimit i cili mbahet pas përfundimit të liqjëratave të lëndës, dhe		

	organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Universitetit. Përmes provimit final studenti maksimalisht mund të arrijë 70% të pikëve nga totali prej 100 pikë. Pjesa tjetër e pikëve prej 30% duhet të plotësohet nga puna grupore në Projekt, aktivitet i realizuar gjatë ligjëratave. Në Kollokvium 1, Kollokvium 2 dhe provim përfundimtar vlerësimi i studenteve do të bëhet përmes një formulari vlerësimi, i cili duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti. Formulari i vlerësimit do të përmbajë pyetje objektive dhe subjektive përmes të cilave do të vlerësohen rezultatet e të nxënësit të studentit: - Pyetjet objektive do të jenë të llojit: (1) Pyetje me zgjedhje të shumëfishta, (2) E Sakte/ Jo e Sakte, (3) Plotësim dhe (4) Kompozim/ Përputhje; pyetje që do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës. - Pyetjet subjektive do të jenë të llojit Ese/detyre me shkrim që do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë dhe vlerësim të problemit, nga përgjigjet e hartuara nga studenti ndaj pyetjes së parashtruar. Aktiviteti në klasë-nënkupton angazhimin e studentit në trajtim të çështjeve të diskutuara në klase, gjatë ligjëratave. Projekti (20%), vlerësim grupor: është aktivitet në të cilin studentet zbatojnë në një projekt konkret njohuritë e fituara. Realizohet në grup prej 2 ose 3 studenteve të cilët kanë për obligim ta realizojnë aktivitetin, dokumentojnë edhe prezantojnë para profesorit të lëndës. Për formën e realizimit dhe dokumentimit të aktivitetit të gjithë anëtarët e grupit do të vlerësohen me pikë të njëjtë (10%), kurse vlerësimi i aftësive prezantuese të aktivitetit është individual dhe përfshinë 10%. Vlerësimi: 91-100 pikë – vlerësohet me notë 10 (dhjetë) 81-90 pikë – vlerësohet me notë 9 (nëntë) 71-80 pikë – vlerësohet me notë 8 (tetë) 61-70 pikë – vlerësohet me notë 7 (shtatë) 51-60 pikë – vlerësohet me notë 6 (gjashtë) 0-50 pikë – Studenti ri-përsëritë në provim.
--	---

Raporti i teorisë dhe praktikës	<i>70% teori me ushtrime dhe 30% punë praktike me raste studimi</i>
Literatura	
Literatura bazë	<i>1. Emeric Solymossy & Safet Merovci, “Ndërmarrësia”, Prishtinë, 2006.</i> <i>2. Bessant, J. dhe Tidd, J. 2007. Innovation and Entrepreneurship. John Wiley and Sons . Ltd.</i>
Literatura shtesë	<i>1 Menaxhimi i Inovacioneve (Skripta) Besnik Krasniqi,</i> <i>2 Baron, R. A., & Shane, S. A. (2008). entrepreneurship: A process perspective (1st ed.).</i> <i>3 “Entrepreneur’s Toolkit”, Harvard Business Essentials, 2005</i>
Plani i dizajnuar i mësimit	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	<i>Prezantimi i syllabusit -Përmbajtja e leksioneve</i>
Java e dytë	<i>Përkufizimi i ndermarresisë dhe inovacionit; Definicioni i Inovacionit ; Specifikat e ndermarresit dhe ndermarrisë. Ndërmarrësia dhe ndërmarrësi si krijues të NVM-ve. Inovacionet dhe NVM-të, rëndësia e Inovacioneve ne Ekonomi.</i>
Java e tretë	<i>Identifikimi i ideve të biznesit, te menduarit kreativ ne biznes, kreativiteti dhe Inovacioni, procesi i zgjidhjes kreative te problemeve ne ndermarrje</i>
Java e katërt	<i>Cikli jetesor i produktit dhe rendesia e krijimit te produkteve te reja dhe inovative. Organizimi i inovacioneve dhe ndërmarrësia, Angazhimet dhe Procesi i krijimit të nje ndermarrjeje.</i>
Java e pestë	<i>Krijimi dhe organizimi i NVM-ve; Investimet e përbashkëta si formë krijimit të bizneseve, Franshiza, regjistrimi i bizneseve.</i>
Java e gjashtë	<i>Planifikimi i biznesit; Plani i biznesit dhe rëndësia e tij, përmbajtja dhe elementet e planit të biznesit, hartimi i planit të biznesit.</i>
Java e shtatë	Vlerësimi i parë
Java e tetë	<i>Analiza e biznesit ekzistues, prezentimi i biznesit, analiza e pozitës konkurruese, objektivat, analiza e tregut , hulumtimi i tregut, përkufizimi i konsumatoreve, segmentimi i tregut, analiza e konkurrencës, plani i marketingut.</i>
Java e nëntë	<i>Analiza Financiare; Rrjedha e Parase, Pasqyra e Suksesit-Humbjes, Bilanci i Gjendjes</i>
Java e dhjetë	<i>Analiza e mjedisit ku aktivitetet e ndermarresise do te realizon: mjedisi politik, ekonomik dhe socio-kultoror.</i>
Java e njëmbëdhjetë	<i>Menaxhimi dhe struktura organizative e ndermarresise; format e financimit të kapitalit punues dhe të aseteve, menaxhimi financiar, faktorët që ndikojnë në rritjen e ndërmarrësisë.</i>
Java e dymbëdhjetë	<i>Roli i institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare në zhvillimin e ndermarresise dhe inovacionit, politikat e qeverisë, përvojat ndërkombëtare.</i>

Java e trembëdhjetë	<i>Treguesit e suksesit financiar; Interpretimi i treguesve financiar.</i>
Java e katërbëdhjetë	<i>Prezentimi i punimeve seminarike nga studentët</i>
Java e pesëmbëdhjetë	<i>Vleresimi i dyte</i>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
<i>Pjesëmarrja e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve është e nevojshme, si dhe pjesëmarrja aktive me diskutimin dhe zgjidhjen e detyrave. Telefonat celularë duhen të fiken ose të vendosen në modalitet të heshtur.</i>	